



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



# **LICENCË PËR OPERATORIN E TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

**DHËNË :**

## **OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMISIONIT DHE TREGUT (KOSTT) SH.A**

**Numri i licencës: ZRRE/Li\_16/17**

**Prishtinë, 13 prill 2017**

## PËRMBAJTJA

Neni 1	Qëllimi .....	3
Neni 2	Përkufizimet .....	3
Neni 3	Të drejtat, detyrimet dhe Autorizimet e dhëna me këtë licence .....	4
Neni 4	Llogaritë e ndara për aktivitetet e licencuara .....	5
Neni 5	Pavarësia Ligjore dhe Menaxheriale .....	6
Neni 6	Ndalimi i Subvencioneve dhe ndër-subvencioneve .....	7
Neni 7	Ndalimi i Diskriminimit .....	7
Neni 8	Modeli i Tregut dhe Rregullat e Tregut .....	7
Neni 9	Aderimi në Rregullat e Tregut .....	8
Neni 10	Komunikimet Operacionale .....	8
Neni 11	Detyrime për Operatorin e Tregut .....	9
Neni 12	Tregu për Shërbime Ndhmëse .....	9
Neni 13	Kufizimet në Përdorimin e Informatës së Caktuar .....	9
Neni 14	Puna .....	10
Neni 15	Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit .....	10
Neni 16	Sigurimi i Informacioneve ndaj Rregullatorit .....	10
Neni 17	Taksat .....	11
Neni 18	Vazhdimi, Modifikimi, Pezullimi, Transferimi dhe Ndërprerja e Licencës .....	11
Neni 19	Masat Administrative dhe Gjobat .....	11
Neni 20	Zgjidhja e Kontesteve .....	11
Neni 21	Hyrja në fuqi .....	12

## Neni 1 Qëllimi

1. **Zyra e Rregullatorit për Energji - ZRRE** (në tekstin e mëtejshëm "Rregullatori"), në pajtim me autoritetin e dhënë me Nenin 36 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084), Ligjin për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081), Ligjin për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085) dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla ZRRE/Nr.07/2017) nëpërmjet kësaj në seancën e datës 13 prill 2017, i ndryshon (modifikon) Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) Sh.A. "Licencën për Operatorin e Tregut të Energjisë", për menaxhimin ekonomik të sistemit të energjisë elektrike (me numër licence ZRRE/Li\_16/12), në **Licencë për Operatorin e Tregut të Energjisë Elektrike, dhënë Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) Sh.A., tani me numër regjistrimi ZRRE/Li\_16/17, Adresa: Rr."Iliaz Kodra" pn. 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës,** (në tekstin e mëtejshëm "i Licencuari").
2. Ndryshimi/modifikimi i kësaj licence vjen si rezultat i ndryshimeve të Legjislacionit primar të sektorin të Energjisë: Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084, i cili ka hyrë në fuqi në korrik 2016); Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081, i cili ka hyrë në fuqi në korrik 2016); Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085, i cili ka hyrë në fuqi në gusht 2016); Ligjit për Gazin Natyror (Ligji Nr. 05/L-082, i cili ka hyrë në fuqi në korrik 2016); si dhe Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla ZRRE/Nr.07/2017, e cila ka hyrë në fuqi me 31 mars 2017).

## Neni 2 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë licencë do të kenë kuptimin si në vijim:
  - a) **Marrëveshja për aderim** - dokumenti i nënshkruar nga Operatori i Tregut dhe pala për aderim, me të cilin bien dakord se do të veprojnë sipas Rregullave të Tregut siç përcaktohet në Rregullat e Tregut;
  - b) **Vit financiar** - periudha prej 1 Janar deri më 31 Dhjetor të të njëjtit vit kalendarik.
  - c) **Legjislacion** – Ligji për Energjinë (Ligji nr. 05/L-081), Ligji për Rregullatorin e Energjisë (Ligji nr. 05/L-084), Ligji për Energjinë Elektrike (Ligji nr. 05/L - 085) si dhe çdo legjislacion tjetër primar apo sekondar që rregullon sektorin e energjisë.
  - d) **Operimi i Tregut**- aktiviteti i ushtruar nga Operatori i Tregut lidhur me menaxhimin e tregut të energjisë elektrike dhe përgatitjen e raporteve financiare për pjesëmarrësit në treg, duke përjashtuar blerjen apo shitjen e energjisë elektrike, në pajtueshmëri me Rregullat e Tregut;
  - e) **Rregulla të Tregut** - norma që rregullojnë tregtimin e energjisë elektrike ndërmjet pjesëmarrësve në treg dhe marrëdhëniet ndërmjet palëve në tregun e energjisë, Operatorit të Tregut dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit, me qëllim të

mirëmbajtjes së balancit fizik në treg.

- f) **Person i ndërlidhur** - çdo ndërmarrje në pronësi apo e kontrolluar nga një ndërmarrje tjetër, siç është përcaktuar në Ligjin për Shoqëritë Tregtare, në fuqi.
2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë licencë do të kenë të njëjtin kuptimin si shprehjet e përdorura në Legjislacionin në fuqi.

### Neni 3

#### Të drejtat, detyrimet dhe Autorizimet e dhëna me këtë licencë

1. I Licencuari do të veprojë në pajtueshmëri me Nenet e përcaktuara në këtë licencë, Ligjin për Energjinë Elektrike, Rregullat e Tregut, Kodet, dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
2. I Licencuari duhet, ndër të tjera:
  - 2.1 të sigurojë që tregu me shumicë i energjisë elektrike në Kosovë është gjatë gjithë kohës i përcaktuar në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe Strategjinë e Energjisë të Republikës së Kosovës në fuqi, siç është dhe mund të ndryshohet kohë pas kohe në përputhje me Ligjin për Energjinë Elektrike;
  - 2.1. të organizojë tregun me shumicë në baza të paanshme, transparente dhe jodiskriminuese, në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi, Rregullat e Tregut dhe procedurat e zhvilluara nga ai dhe të aprovuara nga Rregullatori.
  - 2.2. të organizoj prokurimin (shitblerjen) e energjisë balancuse dhe të kordinohet ngushtë me Operatorin e Sistemit të Transmetimit;
  - 2.3. llogarisë detyrimet për rikthimin e kostove të kryerjes së aktivitetit të licencuar, në pajtim me metodologjinë e aprovuar nga Rregullatori.
  - 2.4. të kryej aktivitetet e përcaktuara për Operatorin e Tregut në kuadër të Rregullës për Skemën Mbështetëse për energjinë e ripërtëritshme dhe ligjeve, rregullave dhe kodeve në fuqi.
3. Territori i mbuluar nga kjo licencë është i tërë territori i Republikës së Kosovës.
4. I Licencuari në përputhje me Rregullat e Tregut, **është i autorizuar** që të kryej aktivitetet si në vijim:
  - 4.1. aderohet në Rregullat e Tregut në cilësinë e “pronarit”;
  - 4.2. mbajë proces për aderim në Rregullat e Tregut për të gjitha Palët Tregtare;
  - 4.3. administrojë tregun e organizuar të energjisë elektrike;
  - 4.4. menaxhojë procesin e ndërrimit të furnizuesit;

- 4.5. mirëmbajë llogaritë për Operatorin e Tregut, Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe të Palëve Tregtare;
  - 4.6. përpilojë dhe dorëzojë te Operatori i Sistemit programet ditore të shitblerjes së energjisë elektrike.
  - 4.7. menaxhojë procesin e barazimit përfundimtar;
  - 4.8. faturojë obligimet reciproke financiare të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Operatorit të Tregut dhe Palëve Tregtare;
  - 4.9. veprojë si agjent për barazim financiar për Operatorin e Sistemit të Transmetimit;
  - 4.10. kryej funksionet komerciale të balancimit të energjisë elektrike, sipas Nenit 23 të Ligjit për Energjinë Elektrike;
  - 4.11. sigurojë informacione mbi tregun e energjisë elektrike; dhe
  - 4.12. ushtrojë funksione të tjera që i janë caktuar me Rregullat e Tregut.
5. I Licencuari nuk do të caktojë dhe/ose transferojë, dhe as nuk do të ketë për qëllim të caktojë ose transferojë ndonjë nga të drejtat ose detyrimet e veta që i janë dhënë me anë të kësaj licence pa aprovimin paraprak të Rregullatorit.

#### **Neni 4**

#### **Llogaritë e ndara për aktivitetet e licencuara**

1. I Licencuari do të përgatisë Pasqyrat Financiare Vjetore për aktivitetet e përfshira në licencë, në përputhje me Udhëzimet Rregullative për Kontabilitetin, të nxjerra nga Rregullatori, dhe do t'i dorëzojë Rregullator një kopje të Pasqyrave Financiare të audituara brenda tre (3) muajve, pas përfundimit të vitit financiar. Llogaritë e brendshme duhet të jenë të ndara për aktivitetet e operimit të tregut dhe llogaritë e brendshme për aktivitetet e tjera, njëjtë sikur këto aktivitete të jenë performuar nga ndonjë ndërmarrje tjetër. Në rast se i licencuari për arsye objektive nuk mund të përgatis këto pasqyra brenda tre (3) muajve, atëherë jo më vonë se 15 mars, i licencuari duhet të kërkojë nga rregullatori shtyrje afati, por jo më vonë se 30 prill të vitit aktual, për dorëzim të këtyre pasqyrave.
2. I Licencuari do të dorëzojë në Rregullator Pasqyrat Financiare Vjetore të audituara nga auditori i pavarur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar brenda afateve të përcaktuara me ligjet në fuqi për raportimin financiar. Auditori duhet të verifikoj se kërkesat lidhur me ndalimin e ndër-subvencioneve dhe diskriminimit në Nenet 5 dhe 6 janë përmbushur.
3. Kontabiliteti rregullativ do të jetë në përputhje me Udhëzimet Rregullative për Kontabilitet, i cili, ndër të tjera, mund të specifikojë:
  - 3.1. formën e regjistrave/pasqyrave të kontabilitetit rregullativ, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në llogaritë e fitimit dhe humbjes (bilanci i suksesit),

bilancin e gjendjes, fitimet e njohura dhe pasqyrat e humbjeve, rrjedhjen e parave të gatshme (cash-flow) dhe deklaratat për shumat e të ardhurave, shpenzimeve, asetëve, detyrimeve, rezervave ose kushteve, të cilat janë tarifuar nga ndonjë aktivitet tjetër, ose janë përcaktuar nga alokimi ose shpërndarja midis aktivitetit të konsoliduar të operimit të tregut dhe ndonjë aktiviteti tjetër;

- 3.2. natyrën dhe përmbajtjen e regjistrave/pasqyrave të kontabilitetit rregullativ, duke përfshirë informacione mbi lloje të specifikuara të të ardhurave vjetore, shpenzimeve, asetëve ose borxheve, dhe informacione mbi të ardhurat vjetore, asetet, shpenzimet dhe detyrimet nga aktivitetet e specifikuara; dhe
  - 3.3. parimet dhe politikat e kontabilitetit rregullativ (duke përfshirë bazat për alokimin e shpenzimeve).
4. Në lidhje me deklaratat e kontabilitetit rregullativ për sa i përket vitit financiar, i Licencuari nuk do të ndryshojë bazën e detyrimeve, shpërndarjes ose alokimit nga ato që janë përdorur në vitin financiar paraprak, përveçse nëse Rregullatori nxjerr më parë udhëzimin relevant ose jep aprovimin me shkrim për ndryshimin e këtyre bazave.
  5. I Licencuari do të veprojë në pajtueshmëri me çdo udhëzim të nxjerrë nga Rregullatori dhe legjislacionin në fuqi.

## **Neni 5**

### **Pavarësia Ligjore dhe Menaxheriale**

1. Për të siguruar pavarësinë e të Licencuarit:
  - 1.1. personat që janë përgjegjës për menaxhimin e të Licencuarit nuk duhet të jenë pjesë e strukturës së ndonjë kompanie të licencuar për prodhim, shpërndarje ose furnizim të energjisë elektrike në Kosovë; dhe
  - 1.2. i Licencuari do të ndërmarr të gjitha masat e duhura për të siguruar që të merren parasysh interesat profesionale të personit përgjegjës për menaxhimin e të Licencuarit, në mënyrën që siguron se ata janë të aftë për të vepruar në mënyrë të pavarur.
2. I Licencuari do të zbatojë Kodin e Sjelljes për Operatorin e Tregut duke specifikuar masat e nevojshme për të siguruar ndalimin e sjelljes diskriminuese. Ky Kod poashtu duhet të përmbaj obligimet specifike të drejtorëve dhe punëtorëve të tjerë për çështjet që kanë të bëjnë me konfidencialitetin, konfliktet e interesit, etj.
3. I Licencuari duhet të publikojë Kodin e Sjelljes në faqen e tij zyrtare elektronike.

## **Neni 6**

### **Ndalimi i Subvencioneve dhe ndër-subvencioneve**

1. Të gjitha detyrimet e vëna nga i Licencuari lidhur me kryerjen e aktiviteteve të tij të licencuara duhet të përcaktohen në pajtim me Rregullën për vendosjen e çmimeve të Operatorit të Tregut dhe ndonjë metodologji tjetër, siç është aprovuar nga Rregullatori.
2. Gjatë kryerjes së aktiviteteve të licencuara të operimit të tregut, i Licencuari duhet të sigurojë se detyrimet e tij nuk janë rritur apo ulur si rezultat i pranimit apo dhënies së ndonjë ndër-subvencioni (direkt apo të tërthortë) nga ose në emër të ndonjë aktiviteti tjetër të tillë të Licencuarit apo nga ndonjë person i ndërlidhur, korporatë ose ndonjë person fizik apo ligjor.

## **Neni 7**

### **Ndalimi i Diskriminimit**

1. I Licencuari nuk do të diskriminojë asnjë Palë Tregtare apo person që dëshiron të bëhet Palë Tregtare, dhe do të kryejë funksionet e veta, duke respektuar parimet e transparencës, objektivitetit dhe pavarësisë.
2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, Pala Tregtare mund të trajtohet ndryshe nga i Licencuari sipas rrethanave të specifikuara dhe të lejuara me Rregullat e Tregut.

## **Neni 8**

### **Modeli i Tregut dhe Rregullat e Tregut**

1. I Licencuari do të zhvilloj Modelin e Tregut në pajtim me ligjet e energjisë, Strategjinë e Energjisë të Republikës së Kosovës, siç ndryshohet herë pas herë, në konsultim me Palët Tregtare dhe institucionet tjera relevante përgjegjëse për sektorin e energjisë.
2. I Licencuari duhet të zhvillojë Rregullat e Tregut në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe Modelin e Tregut, siç është aprovuar nga Rregullatori.
3. I Licencuari do të jetë përgjegjës për menaxhimin dhe modifikimin e Rregullave të Tregut, nën dispozitat përkatëse të Rregullave të Tregut. I Licencuari në rast të modifikimit të Rregullave të Tregut duhet të dorëzojë propozimet për modifikim në Rregullator për aprovim, pas konsultimit me palët që do të ndikohen nga ky modifikim.
4. Modifikimet e referuara në paragrafin 3 të këtij neni mund të propozohen nga i Licencuari, nga Rregullatori ose nga ndonjë palë në Rregullat e Tregut.

**Neni 9**  
**Aderimi në Rregullat e Tregut**

1. I Licencuari do të hyjë në Marrëveshje për Aderim me të gjithë personat që dëshirojnë të nënshkruajnë një marrëveshje të tillë dhe të bëhen Palë në Rregullat e Tregut, dhe të cilët janë të Licencuar për aktivitetet që dëshirojnë t'i ndërmarrin . I Licencuari do të njoftojë Rregullatorin për të gjitha kërkesat e pranuar nga personat që dëshirojnë të hyjnë në Marrëveshje për Aderim, në përputhje me dispozitat e Rregullave të Tregut.
2. I Licencuari është i detyruar të monitorojë përputhshmërinë e Palëve Tregtare sipas Marrëveshjeve Tregtare, Marrëveshjeve për Aderim, dhe në përputhje me Rregullat e Tregut.
3. I Licencuari mund t'i përfundojë këto Marrëveshje për Aderim vetëm në përputhje me dispozitat e Rregullave të Tregut.

**Neni 10**  
**Komunikimet Operacionale**

1. I Licencuari, për qëllim të menaxhimit të procesit të barazimeve përfundimtare, do të instalojë, mirëmbajë dhe azhurnojë platformën e operimit të tregut, duke përfshirë çdo standard të kërkuar për komunikim me këtë softuer, në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe Rregullat e Tregut.
2. I Licencuari do të sigurojë që i gjithë procesi për barazimet përfundimtare është audituar nga një kompani e pavarur dhe e kualifikuar e auditimit, për të përcaktuar përputhjen me Rregullat e Tregut. Auditimi do të kryhet në pajtim me nenin 21.7 të Rregullave të Tregut dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
3. I Licencuari do të mirëmbajë shënime të plota dhe të sakta për të gjitha të dhënat për barazimet përfundimtare që janë paraqitur nga Palët Tregtare ose që janë mirëmbajtur nga i Licencuari. Format i ruajtjen e këtyre shënimeve do të përcaktohet nga i Licencuari.

Në këtë Nen:

***“Të Dhënat e barazimit përfundimtar”*** - janë të gjitha të dhënat që nevojiten të furnizohen nga i Licencuari ose nga Palët Tregtare sipas Rregullave të Tregut, që mundësojnë kryerjen e barazimit përfundimtar sipas Rregullave të Tregut.



## **Neni 11**

### **Detyrime për Operatorin e Tregut**

Të gjitha ngarkesat e vëna nga i Licencuari lidhur me performancën e aktivitetit të tij të licencuar duhet të vendosen në pajtim me Rregullën për vendosjen e çmimeve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Operatorit të Tregut dhe ndonjë metodologji tjetër e aprovuar nga Rregullatori.

## **Neni 12**

### **Tregu për Shërbime Ndhmëse**

1. Jo më vonë se tre (3) muaj pas dhënies së kësaj licence të modifikuar, i Licencuari ,në koordinim me Operatorin e Sistemit të Transmetimit, duhet të përgatisë një draft-Procedurë për vendosjen e çmimeve dhe ofrimin e shërbimeve ndihmëse dhe duhet ta dorëzojë në Rregullator për rishikim fillestar dhe miratim. Procedura duhet të sigurojë se, deri sa rrethanat të ekzistojnë për prokurim konkurrues, shërbimet ndihmëse prokurohen me çmimin më të mirë ekonomik, duke marrë parasysh sasinë, natyrën dhe shumëllojshmërinë e burimeve të shërbimeve ndihmëse të disponueshme për të Licencuarin.
2. Pasi ka marrë parasysh komentet e Rregullatorit për draft-metodologjinë, i Licencuari duhet të konsultohet me palët tregtuese para finalizimit të draftit.
3. I Licencuari duhet të dorëzojë Procedurën e finalizuar për aprovim në ZRRE dhe duhet të implementojë Procedurën e aprovuar, përveç nëse udhëzohet ndryshe nga ZRRE.
4. I Licencuari duhet të njoftojë Rregullatorin për çmimet e shërbimeve ndihmëse, të prokuruar në pajtim me Procedurën.

## **Neni 13**

### **Kufizimet në Përdorimin e Informatës së Caktuar**

1. Të gjitha të dhënat e siguruar nga i Licencuari gjatë kryerjes së detyrave të tij mund të zbulohen në pajtim me Rregullat e Tregut dhe ndonjë legjislacion në fuqi.
2. I Licencuari duhet, kur është e nevojshme për kryerjen e aktivitetit të licencuar, të zbulojë çdo informacion përveç informacionit konfidencial, të cilat janë mbajtur ose siguruar gjatë performancës së funksioneve të tij si Operator i Tregut. Pavarësisht nga kjo, i Licencuari duhet të zbulojë informata, duke përfshirë informatat konfidenciale, nëse një informacion i tillë kërkohet nga Rregullatori.
3. I Licencuari do të sigurojë se çdo dokument që përmban informata konfidenciale, duhet qartë të identifikojë informatën si konfidenciale (ta shënjojë atë si informatë konfidenciale).

Në këtë Nen **"Informata konfidenciale"** do ta ketë kuptimin e njëjtë të përcaktuar në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

#### **Neni 14 Puna**

Lidhur me marrëdhënien në punë dhe sigurinë në punë, i Licencuari do të veprojë në pajtim me legjislacionin në fuqi në Kosovë.

#### **Neni 15 Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit**

1. I Licencuari do të njoftojë Rregullatorin për ndonjë ndryshim që pritet në kontroll së paku gjashtëdhjetë (60) ditë paraprakisht. Ndryshimi në kontroll nuk do të jetë efektiv deri sa Rregullatori nuk e aprovon atë.
2. I Licencuari do të njoftojë Rregullatorin për ndonjë ndryshim të strukturës organizative të të Licencuarit. Njoftimi i tillë do t'i bëhet Rregullatorit jo më vonë se tri (3) ditë nga data e çdo ndryshimi të tillë.

#### **Neni 16 Sigurimi i Informacioneve ndaj Rregullatorit**

1. I Licencuari do të dorëzojë në Rregullator informacione dhe raporte në mënyrën dhe në afatet që Rregullatori mund t'i konsiderojë të nevojshme.
2. I Licencuari do të dërgojë në Rregullator raporte mbi veprimtarinë e Operatorit të Tregut si dhe pajtueshmërinë me kushtet e Licencës, në pajtim me Doracakun e Raportimit për Sektorin e Energjisë, të miratuar nga Rregullatori, dhe sipas kërkesave të Rregullatorit.
3. I Licencuari duhet t'i dërgojë Rregullatorit detajet për çdo ndryshim në informata që janë dërguar gjatë aplikimit për këtë licencë.

Në këtë Nen:

**"Informacion"** – materiali në çdo formë dhe pa asnjë kufizim do të përfshijë çdo kontratë, libër, dokument, regjistër, llogaritje (statusore ose tjetër), vlerësim, kthim ose raport të çdo përshkrimi dhe çdo shpjegim (gojor ose me shkrim) në lidhje me këto informacione që mund të jenë kërkuar nga Rregullatori.

## **Neni 17**

### **Taksat**

I Licencuari duhet t'i paguaj Rregullatorit çdo taksë fillestare ose vjetore, siç përshkruhet në Rregullën për taksat, të miratuar nga Rregullatori.

## **Neni 18**

### **Vazhdimi, Modifikimi, Pezullimi, Transferimi dhe Ndërprerja e Licencës**

1. Rregullatori mund të vazhdojë, modifikojë, pezullojë, dhe ndërpresë këtë licencë në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
2. Rregullatori mund të transferojë këtë licencë në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, por duke siguruar që obligimet e licencës mund të kryhen nga i Licencuari tjetër dhe nëse konsumatorët nuk do të dëmtohen për shkak të një transferimi të tillë.

## **Neni 19**

### **Masat Administrative dhe Gjobat**

1. Në rast shkeljeje të dispozitave të legjislacionit në fuqi, përfshirë Rregullat e nxjerra nga Rregullatori, Nenet e kësaj Licence apo instruksionet dhënë të Licencuarit nga ana e Rregullatorit, Rregullatori ka kompetenca t'i vendos të Licencuarit masa administrative dhe gjoba, në përputhje me Nenin 57 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat.
2. Masat administrative dhe gjobat mund t'i vendosen ndërmarrjes si subjekt juridik si dhe personave përgjegjës të ndërmarrjes.
3. Shuma e gjobës do të vlerësohet në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat.

## **Neni 20**

### **Zgjidhja e Kontesteve**

1. Çdo kontest që paraqitet apo është i lidhur me aktivitetet e licencuara do të zgjidhet në përputhje me Rregullën për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të nxjerrë nga Rregullatori.
2. Vendimet e Rregullatorit lidhur me vazhdimin, modifikimin, pezullimin, ndërprerjen dhe transferin e licencës si dhe vendimet lidhur me gjobat si rezultat i shkeljeve të kushteve

të licencës apo shkeljes së ligjeve të aplikueshme, mund të kontestohen nga i Licencuari në gjykatën kompetente sipas ligjeve në fuqi.

**Neni 21**  
**Hyrja në fuqi**

1. Në pajtim me Nenin 36 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, kjo licencë e ndryshuar/modifikuar tani me numër regjistrimi ZRRE/Li\_16/17 i lëshohet Operatorit të **Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) SH.A**, për aktivitetin e operimit të tregut të energjisë elektrike, dhe hynë në fuqi me datë **13.04.2017**.
2. Licenca e lëshuar me datë **04 Tetor 2006** (Nr. i Licencës ERO/Li\_16/06), e modifikuar me 18.07.2012 (Nr. i Licencës ZRRE/Li\_16/12), tani e modifikuar 13.04.2017 (Nr. i Licencës ZRRE/Li\_16/17) do të vazhdoj të jetë e vlefshme për një periudhë tridhjetë (30) vjeçare, deri më **04 Tetor 2036**.



E vulosur me vulën e rëndomtë të Zyrës së Rregullatorit për Energji me: \_\_\_\_\_.

Nënshkruar (në emër të Bordit të Rregullatorit) U.D Krenar Bujupi. \_\_\_\_\_

Nënshkruar më: 13.04.2017.

Fundi i dokumentit